



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

### V E N D I M

## PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATES TË OJQ-SË PËRFITUESE PËR AKTIVITETET E KULTURËS DHE SPORTIT DUKE PËRFSHIRË ORGANIZIMIN E FESTIVALIT "MËRGATA FEST 2023" LIPJAN

#### Neni 1

Me këtë Vendim, **Islam Sylejmani**, Zyrtar në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontrates të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe OJQ-së për realizimin e projektit për avancimin dhe afirmimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjanit duke përfshirë organizimin e festivalit "Mërgata Fest 2023".

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontrates të OJQ-së si vijon :

Nr.	Emërtimi i OJQ-së
1.	OJQ DRINK FUN DANCE "PI KENACU VALLEZO"

#### Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontrates të lidhur mes Komunës dhe OJQ-së të cekura konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

#### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës Islam Sylejmani dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

INr. 453 /01- 36759  
Lipjan, më 18.07.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

**Neni 1**  
**Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (klubeve sportive) në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-30709 të datës 14.06.2023, në përbërje si vijon:

1. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Fidan Tmava nga OJQ-të, anëtare
5. Kamer Podrimqaku, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit, anëtar
6. Saranda Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare rezerv

**Neni 2**  
**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (klubeve sportive) në Komunën e Lipjanit konform Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-30709 të datës 14.06.2023, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-36762  
Lipjan, më 18.07.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L- 040- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 të datës 4 qershor 2008, si dhe të neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr këtë :

**V E N D I M**  
( për korrije - shirjet 2023)

**Neni 1**

Obligohet, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, që të organizojë procesin e fushatës së korrije-shirjeve për vitin 2023 në territorin e Komunës së Lipjanit.

**Neni 2**

Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, formon komisionin profesional për monitorimin e procesit të korrije-shirjeve për vitin 2023 në territorin e Komunës së Lipjanit.

**Neni 3**

Autokombajnerët duhet të jenë të pajisur me mjetet e nevojshme gjatë procesit të korrije-shirjeve si mjete kundër zjarrit, rezervuar me ujë, lopatën, kazmën, rërën etj.

**Neni 4**

Autokombajnerët obligohen që të respektojnë rendin e korrije-shirjeve, autokombajnati duhet të jenë në gjendje të mirë teknike, të mos ketë rrjedhje të drithërave më tepër se 5%.

**Neni 5**

Autokombajnerët udhëzohen që të respektojnë rekomandimin e MBPZHR, për lartësinë e çmimit të korrije-shirjes prej 130 € për një hektarë.

**Neni 6**

Mbikqyrjen e këtij vendimi e bënë Drejtorat për Bujqësi dhe Pylltari si dhe Inspektori i Bujqësisë.

**Neni 7**

Pas përfundimit të fushatës së korrije-shirjeve, Komisioni për monitorimin e procesit të korrije-shirjeve harton raportin e punës lidhur me mbarëvajtjen e procedurës së korrije-shirjeve për vitin 2023.

**Neni 8**

Ky vendim hynë në fuqi menjëher dhe me këtë Vendim do të njoftohet Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari si dhe Drejtorati për Inspektorat.

INr. 320/01-34994  
Lipjan, më 10.07-2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës, nxjerr:

### VENDIM

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

#### Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **7,280.00€**, (shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-33629 të datës 03.07.2023, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 26 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin qershor të vitit 2023 me nga 280 euro për secilin rast  $26 \times 280 = 7,280.00€$ , të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

#### Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB .

#### Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

#### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame e Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-33629  
Lipjan, më 04.07.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për avancimin dhe afirmimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjanit duke përfshirë organizimin e festivalit “Mërgata Fest 2023” Nr.5-453/01-35413 të datës 11.07.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR AKTIVITETET E PROJEKTIT PËR**  
**AVANCIMIN DHE AFIRMIMIN E KULTURËS DHE SPORTIT NË KOMUNËN E**  
**LIPJANIT**

**Neni 1**

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **25,000.00 €** (njëzet e pesë mijë euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-në DRINK FUN DANCE “PI KENAQU VALLEZO” nga Lipjani për realizimin e aktiviteteve të projektit për avancimin dhe afirmimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjanit duke përfshirë organizimin e festivalit “Mërgata Fest 2023” sipas Projekt- Propozimit të paraqitur sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.1-453/01-29036 e datës 06.06.2023.

2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna për projektin avancimin dhe afirmimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjanit duke përfshirë organizimin e festivalit “Mërgata Fest 2023”:

Nr.	Emërtimi i OJQ-së	Shuma
1.	OJQ-ja DRINK FUN DANCE “PI KENAQU VALLEZO”	25,000.00 €
	Shuma Totale	<b>25,000.00 €</b>

**Neni 2**

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2023 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Neni 3**

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen me Kontratë të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.453/01-35413/2  
Lipjan, më 12.07.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM  
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR FORMIMIN E GRUPIT  
PUNUES 1NR.020/04-16831 I DATËS 04.04.2023

**Neni 1**

I. Me këtë Vendim ndyshohet dhe plotësohet neni 1 i Vendimit për formimin e grupit punues 1Nr.020/04-16831 i datës 04.04.2023 dhe riformulohet si vijon:

Neni 1- Përbërja

Formohet, grupi punues për shqyrtimin e kërkesave –ofertave të personave fizik dhe juridik për marjen në shfrytëzim të pronave komunale përmes procedurës së negocimit konform dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje si vijon:

1. Valon Pacolli, Kryesues
2. Latif Ramadani, anëtar
3. Safete Amerllahu, anëtare
4. Imri Semetishti, anëtar
5. Rexhep Rexhepi, anëtar
6. Zyrtar nga sektori pronësor –juridik, procesmbajtës

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet, Kryesuesi, anëtarët e grupit punues dhe Sektori pronësor juridik.

1Nr.020/04-16831/2  
Lipjan, më 05.07.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve-strehimoren në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare dhe atyre të dhunës gjinore 15Nr.400/01-33610 i datës 30.06.2023 në zbatim të dispozitave të nenit 2 të Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës, Komunës së Prishtinës” dhe Qendrës për Mbrojtjen e grave dhe fëmijëve në Prishtinë 1Nr-660/03-53582 të datës 04.10.2022, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë

## VENDIM PËT TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

### Neni 1

Më këtë Vendim, TRANSFEROHET, shuma e mjeteve në vlerë prej prej **3,300.00 €** (tre mijë e treqind) euro në zbatim të dispozitave të nenit 2 të Memorandumit të mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Fushë Kosovës, Lipjanit, Obiliqit, Podujevës dhe Prishtinës me Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve me seli në Prishtinë 1Nr-660/03-53582 të datës 04.10.2022 si dhe Kërkesës së QMGF dërguar Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale Nr.3-400/01-23389 të datës 05.05.2023.

### Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF NGO) në nr.XK051110052260000121 në ProCredit Bank.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

1Nr. 400/01-38561  
Lipjan, më 26.07.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 , Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare Organizatës "Help" Nr.15-400/01-33617 të datës 30.06.2023 si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-300/01-16009 të datës 30.03.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës Help-Hilfe zur Selbsthilfe e. V. , Kryetari i Komunes, nxjerr

## VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

### Neni 1

1.Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve më vlerë prej **19.200.00 €** (nëntë mbëdhjetë mijë e dyqind euro) konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-300/01-16009 të datës 30.03.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës Help-Hilfe zur Selbsthilfe e. V., me qëllim të realizimit të projektit të përbashkët me titull "Përfshirja dhe Fuqizimi Ekonomik në Ballkanin Përendimor" i financuar nga Qeveria gjermane dhe zbatuar nga Help, ku Komuna e Lipjanit obligohet të participojë me shumën e mjeteve financiare të cekur më lartë, i cili projekt ka synim përfshirjen dhe fuqizimin ekonomik në ballkanin përendimor në mënyrë që të rrisë, përmirësojë kushtet e jetesës për të marginalizuarit dhe grupet e cenueshme në ballkanin përendimor, ku përkrahja planifikohet tu ofrohet grupeve të cenueshme shoqërore, grave, të rinjëve, personave me aftësi të kufizuara dhe komuniteteve lokale përmes fuqizimit ekonomik dhe ndërtimit të aftësive personale dhe profesionale, ku në kuadër të këtij projekti është planifikuar që të paktën 20 biznese të mbështeten në synimet e tyre për të filluar ose zhvilluar biznesin e tyre.

### Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari në xhirollogarinë bankare të Organizatës Help me nr.1110339387010117 në Procredit Bank.

### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 400/01-38563  
Lipjan, më 26.07.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 40 të Ligjit Nr.2004/18 për tregtinë e brendshme neneve 40 dhe 41 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM  
PËR ZGJATJEN E ORARIT TË PUNËS TË SUBJEKTEVE TË BIZNESIT NË QYTETIN E  
LIPJANIT

**Neni 1**

Me këtë Vendim, përcaktohet zgjatja e orarit të punës për subjektet e biznesit në lëmin e tregtisë dhe hotelerisë (restorantet, motelet, kafiteritë) të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të qytetit të Lipjanit.

**Neni 2**

- 1.Zgjatja e orarit të punës bëhet për sezonën verore e cila ndërlidhet me fluksin e ardhjes së bashkë atdhetarëve nga diaspora.
- 2.Kjo zgjatje e orarit të punës fillon prej datës 22.07.2023 deri më 15.09.2023, ku subjektet e lartëcekura mund të ushtrojnë veprimtaritë e tyre gjatë ditëve të javës : e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte dhe e diel deri në ora 00:00 ndërsa të gjatë ditëve të javës : e premte dhe e shtunë deri në ora 01:00 pas mesnate.
- 3.Zgjatja e orarit të punës të subjekteve të biznesit nuk nënkupton edhe zgjatjen e orarit të punës të punëtorëve më shumë se 8 orë pune në ditë.
- 4.Subjektet e lartëcekura gjatë kësaj periode obligohen që pas orës 23:00 ta ndalin zërin e muzikës.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

**Neni 4**

Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektorat i Komunës së Lipjanit.

1Nr. 330/02-37683  
Lipjan, më 21.07.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti